



Republika e Maqedonisë së Veriut
MINISTRIA E EKONOMISË DHE PUNËS

Në bazë të Programit për mbështetjen e konkurrencës së Industrisë përpunuese dhe përgjegjesisë shoqërore për vitin 2024 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.15/2024), pjesa II. fusha A. Implementimi i politikës industriale, Masa 2. Vendosje dhe avancim të konceptit të ekonomisë cirkulare, Ministria e Ekonomisë dhe Punës shpallë:

THIRRJE PUBLIKE

për kompensimin e një pjese të kostove të subjekteve afariste për vendosjen dhe avancimin e konceptit të ekonomisë cirkulare për vitin 2024

I

Lënda e thirrjes publike

Lëndë e Thirrjes Publike është kompensimi i një pjese të kostove të dëshmuara të subjekteve afariste (në tekstin e mëtejme: Kërkuesi) për vendosjen dhe avancimin e konceptit të ekonomisë cirkulare, për aktivitetet e mëposhtme:

- 1.1. Zhvillim dhe zbatim të modeleve cirkulare të biznesit dhe/ose sistemeve organizative që çojnë në zvogëlimin e mbeturinave në procesin e mëtejshëm të realizimit të projektit;
- 1.2. Zhvillim i produkteve të reja nga lëndët e para të ricikluara ose sekondare;
- 1.3. Furnizim i një thërrmuesi për thërrmimin e produkteve të ndryshme të përdorura me qëllim të ripërfshirjes së tyre në procesin e prodhimit si repromaterial;
- 1.4. Furnizim i linjave/makinave të vogla për përzgjedhjen e mbetjeve për nevojat e personave juridikë, të cilët kanë leje për menaxhimin e mbetjeve;

II

Vëllimi dhe shpërndarja e mjeteve financiare

Për realizimin e aktiviteteve, është përcaktuar buxhet në shumën totale prej 6.000.000.00 denarë.

Me buxhetin do të bëhet kompensimi i një pjesë të kostove në shumën prej 50% të kostove të dëshmuara të bëra në vitin 2023 ose 2024¹, por jo më shumë se 350.000.00 denarë individualisht për secilin subjekt afarist – kërkues i mjeteve. Llojet e shpenzimeve të pranueshme për kompensim janë dhënë në Rregulloren (Shtojca Nr1 dhe 2) që është pjesë përbërëse e kësaj Thirrjeje Publike.

Me qëllim që të kontribuohet në zhvillimin e balancuar rajonal, përveç shumës së kompensimit të përcaktuar në Lëndën e Thirrjes Publike, kërkuesit do të marrin mbështetje shtesë financiare në varësi të rajonit të planifikimit nga i cili është selia e kërkuesit. Mbështetja financiare shtesë do të llogaritet bazuar në diferencën procentuale midis rajonit të planifikimit me vlerën më të lartë të² PBB-së për kokë banori dhe vlerës së PBB-së për kokë banori të rajonit planor në të cilin është selia e kërkuesit.

Shpërndarja e mjeteve financiare do të bëhet sipas parimit "i pari i ardhur, i pari i shërbyer", respektivisht sipas renditjes së parashtrimit të kërkesave në Sekretarinë e arkivit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës, dhe përmbushjen e kushteve të definuara në këtë Thirrje publike, deri në shterimin e buxhetit në dispozicion.

Nëse buxheti i përcaktuar shterohet ndërsa thirrja publike është ende në rrjedhë, Ministria e Ekonomisë dhe Punës do të publikojë në faqen e saj të internetit www.economy.gov.mk dhe një njoftim për mbylljen e thirrjes publike për shkak të shterimit të fondeve në dispozicion.

III

E drejta për të marrë pjesë në Thirrjen publike

Të drejtën e pjesëmarrjes në Thirrjen publike e ka çdo subjekt tregtar afarist i themeluar në përputhje me Ligjin për shoqëritë tregtare dhe i regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që i plotëson kushtet e mëposhtme të përgjithshme, respektivisht kushtet e pranueshmërisë:

- ka 100% pronësi private, ku të paktën 50,1% është në pronësi të një person-i (ave) shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe/ose të subjekteve

¹ vitet kur është bërë pagesa e plotë e faturave për kostot e bëra

² të dhënat më të fundit të disponueshme të PBB-së për kokë banori sipas rajoneve që publikon Enti Shtetëror i Statistikave të Republikës së Maqedonisë së Veriut

afariste të themeluara nga persona shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;

- ka selinë afariste në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- nuk është subjekt i sapokrijuar afarist³;
- nuk ka marrë në dy vitet e mëparshme fiskale (2022 dhe 2023) dhe në vitin aktual fiskal (2024) ndihmë nga burime të tjera (thirrje publike të ministrive, agjencive qeveritare, komunave, institucioneve të tjera publike, ndihmë për kompensimin e shpenzimeve të bëra të njëjta me ato për të cilat kërkohet kompensim sipas Thirrjes publike;
- ka të paktën 5 (pesë) persona të punësuar me orar të pacaktuar pune;
- nuk ka humbje financiare në vitin e mëparshëm;
- nuk ka detyrim të papaguar në bazë të detyrimeve doganore dhe detyrimeve të tjera importuese;
- nuk ka detyrime të pashlyera tatimore, respektivisht tatime, kontribute dhe taksa të tjera publike të papaguara, përveç nëse i është aprovuar pagesa e shtyrë e tatimeve, kontributeve ose kontributeve ose taksave të tjera publike në përputhje me rregulloret e veçanta dhe të njëjta i paguan rregullisht;
- ka statusin e subjektit aktiv afarist, mbi të cilin nuk është hapur asnjë procedurë falimentimi ose likuidimi;
- kundër subjektit afarist nuk janë nisur procedura për ekzekutimin e detyruar të kërkesave të maturuara monetare;
- ndalimi i ushtrimit të veprimtarisë së veçantë ose ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të një veprimtarie të veçantë.

Për pjesëmarrje në thirrjen publike për aktivitetet nën numrin rendor 1.1, 1.2. dhe 1.3. të Pjesës I – Lëndë e thirrjes publike, subjekti afarist duhet të plotësojë gjithashtu kushtin e posaçëm për të pasur veprimtari prioritare/shifrën kryesore e të ardhurave në sektorin S/C – Industria përpunuese në përputhje me Klasifikimin kombëtar të veprimtarive – Rev.2.⁴ (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.147/2008 dhe 4/2013).

Për të marrë pjesë në thirrjen publike për aktivitetin sipas numrave rendor 1.3. dhe 1.4. të Pjesës I – Lëndë e thirrjes publike, subjekti afarist duhet të plotësojë edhe kushtin e posaçëm për thërrmimin e produkteve të ndryshme të përdorura,

³ Data e regjistrimit të themelimit të subjektit në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut të jetë më e vjetër se 2 (dy) vjet nga data e parashtrimit të dokumenteve sipas Thirrjes publike.

⁴ Shënim: Aktiviteti mbizotërues i një filiali në kuadër të subjektit afarist - kërkues nuk do të merret parasysh.

respektivisht linjën/makinën e e vogël për përzgjedhjen e mbetjeve, duhet të jetë e re dhe e prodhuar jo më herët se 2 (dy) vjet nga data e blerjes së saj.

Për të marrë pjesë në thirrjen publike për aktivitetin nën numrin rendor 1.4. të Pjesës I – Lënda e thirrjes publike, subjekti afarist duhet të plotësojë edhe kushtin e posaçëm për të pasur leje të vlefshme për menaxhimin e mbetjeve të lëshuar nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor.

IV

Dokumentet e nevojshme për paraqitje në Thirrjen publike

Për pjesëmarrje në Thirrjen publike, subjekti afarist-kërkuesi parashtron kërkesë, si më poshtë :

- nëse subjekti afarist - kërkuesi parashtron dokumentet për aktivitetet sipas pikës 1.1. dhe 1.2. të pjesës I – Lëndë e thirrjes publike:

Kërkesë për kompensimin e një pjese të kostove që lidhen me një projekt zhvillimor në fushën e ekonomisë cirkulare (Formulari nr. 1);

- nëse subjekti afarist - kërkuesi parashtron dokumentet për aktivitetet sipas pikës 1.1. dhe 1.2. të pjesës I – Lëndë e thirrjes publike:

Kërkesë për kompensimin e një pjese të kostove për furnizimin e makinave ose impianteve të reja⁵ për aktivitete që lidhen me ekonominë cirkulare (Formulari nr.2).

Bashkë me kërkesën përkatëse dorëzohen edhe dokumentet e përgjithshme të mëposhtme, të cilat përbëjnë pjesën integrale dhe të detyrueshme të saj:

- Deklarata e pranimit të kushteve për aplikim të Thirrjes Publike, e vërtetuar nga noteri (Formulari nr.3);
- Deklaratë e dhënies së ndihmës shtetërore dhe/ose ndihmës me rëndësi të vogël (de minimis) (Formulari nr.4)⁶;
- Vërtetim nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut për statusin aktual të subjektit afarist, jo më i vjetër se 60 ditë nga data e parashtrimit të kërkesës;

⁵Me termin “Makinai ose impiante” nënkuptohet një thërmues për thërrmimin e produkteve të ndryshme të përdorura me qëllim të ripërfshirjes së tyre në procesin e prodhimit si repromaterial, si dhe linja/makina të vogla për përzgjedhjen e mbetjeve.

⁶ Të plotësohet vetëm nëse subjekti afarist – kërkuesi ka marrë më parë ndihmë tjetër shtetërore dhe/ose ndihmë me rëndësi të vogël (de minimis)

- Informacion për gjendjen ekonomike financiare të subjektit afarist të lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, jo më të vjetër se 60 ditë;
- Vërtetim nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut se ndaj subjektit afarist nuk është hapur procedurë e falimentimit, jo më e vjetër se 60 ditë nga data e parashtrimit të kërkesës;
- Vërtetim nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut se ndaj subjektit afarist nuk është hapur procedurë e likuidimit, jo më e vjetër se 60 ditë nga data e parashtrimit të kërkesës;
- Vërtetim nga Drejtoria Doganore se subjekti tregtar nuk ka borxh të papaguar në bazë të detyrimeve doganore dhe taksave të tjera importuese, jo më të vjetra se 60 ditë nga data e parashtrimit të kërkesës;
- Certifikatë nga Drejtoria e të Ardhurave Publike se subjekti afarist nuk ka detyrime të pashlyera të maturuara tatimore, jo më të vjetra se 60 ditë nga data e parashtrimit të kërkesës;
- Vërtetim nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut (me listë) për të punësuarit e rregullt me orar të plotë në subjektin afarist, jo më të vjetër se 60 ditë nga data e parashtrimit të kërkesës;
- Vërtetim nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut për dënime të shqiptuara dytësore⁷ dhe/ose sanksione kundërvajtëse të⁸ regjistruara në Regjistrin e dënimeve dytësore për veprat penale të kryera të personave juridikë dhe Regjistrin e personave fizikë dhe juridikë të cilëve u është shqiptuar sanksion ndalim të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës dhe ndalim të përkohshëm të ushtrimit të veprimtarisë së veçantë;
- Dëshmi e llogarisë së transaksionit (kopje e llogarisë së transaksionit) të subjektit afarist – kërkuarit;

⁷ Veçanërisht për dënimet dytësore të mëposhtme për personat juridikë sipas Kodit Penal (neni 95):

1) ndalimin e pjesëmarrjes në procedurat e thirrjes publike, dhënien e kontratave për furnizim publik dhe kontratave për partneritet publiko-privat;

2) ndalimin e përdorimit të subvencioneve, të kredive të tjera të favorshme ose të formave të tjera të ndihmës publike;

3) ndalimi i përkohshëm ose i përhershëm për ushtrimin e veprimtarive të caktuara.

⁸ I referohet kundërvajtjeve të personave juridikë në përputhje me Ligjin për kundërvajtjet (neni 34 dhe neni 39):

1) ndalimi i përkohshëm i ushtrimit të veprimtarisë së veçantë të një personi juridik, dhe

2) ndalimi i ushtrimit të një veprimtarie të veçantë të një personi juridik.

- Dëshmi e taksave të paguara administrative (fletëpagesa për taksa të paguara administrative) në vlerë prej 50,00 denarë dhe 250,00 denarë (shih Shtojcën nr.3 – Udhëzim për plotësimin e fletëpagesave).

Bashkë me kërkesën për kompensimin e një pjese të kostove që lidhen me një projekt zhvillimor në fushën e ekonomisë cirkulare (Formulari nr.1), krahas dokumenteve të përgjithshme, dorëzohen edhe dokumentet specifike si më poshtë:

- Raport për realizimin e projektit me tregues të performancës⁹ - projekti zhvillimor (i përgatitur në përputhje me Shtojcën nr.4 - Udhëzime për përgatitjen e raportit për projektin e realizuar me tregues të performancës – projekti zhvillimor);
- Pasqyrë e shpenzimeve të bëra në lidhje me projektin zhvillimor në fushën e ekonomisë cirkulare me nënshkrimin e personit të autorizuar të kërkuesit (Formulari nr.5 – Pasqyrë e shpenzimeve të bëra);
- Kopje të faturave për shpenzimet e bëra në lidhje me realizimin e projektit zhvillimor (të besueshme me origjinalin, të nënshkruara dhe të vulosura nga ndërmarrja);
- Kopjet e kontratave për angazhimin e¹⁰ personelit të kualifikuar, të punësuar ose të angazhuar në projektin zhvillimor;
- Kopjet e kontratave për hulumtim kontraktual, njohuri teknike, patentat dhe shërbimet e konsulencës që janë ekskluzivisht për nevojat e aktiviteteve të projektit zhvillimor, dhe
- Dëshmi të pagesës së kryer për shpenzimet e bëra në lidhje me projektin zhvillimor në bazë të faturave të lëshuara, respektivisht certifikatë nga llogaria bankare e kërkuesit.

Bashkë me kërkesën për kompensimin e një pjese të kostove për furnizimin e makinave ose impianteve të reja për aktivitete që lidhen me ekonominë cirkulare (Formulari nr.2), dorëzohen edhe dokumentet specifike si më poshtë:

- Raport për realizimin e projektit me tregues të performancës¹¹ - makina (i përgatitur në përputhje me Shtojcën nr.5 - Udhëzues për përgatitjen e raportit për projektin e realizuar me tregues të performancës - makinat);

⁹ Përshkrim i shkurtër i projektit zhvillimor dhe aktiviteteve të realizuara në lidhje me të.

¹⁰ “Personel me kualifikim të lartë” janë hulumtuesit, inxhinierët, projektuesit dhe menaxherët e marketingut me arsim të lartë dhe të paktën pesë vjet përvojë përkatëse profesionale.

- Kopje e kontratës për furnizimin e makinës ose impiantit (e besueshme me origjinalin, e nënshkruar dhe e vulosur nga ndërmarrja);
- Kopje e deklaratës doganore (e besueshme me origjinalin, e nënshkruar dhe e vulosur nga ndërmarrja);
- Kopje e fatur-ës (ave) për makinën ose impiantin e furnizuar (e besueshme me origjinalin) - nëse fatura/t është/janë në gjuhë të huaj, është gjithashtu e nevojshme të dorëzohet një përkthim në maqedonisht nga një përkthyes i autorizuar gjyqësor;
- Dëshmi e pagesës së fatur-ës (ave) për makinën ose impiantin e furnizuar (certifikatë bankare ose SWIFT, që tregon se janë shlyer plotësisht detyrimet e faturës);
- Dokumentacioni fotografik, deklaratata e prodhimit ose dokumenti tjetër i lëshuar nga prodhuesi/tregtari (shitësi) i makinës ose impiantit nga i cili mund të përcaktohet padyshim data e prodhimit;
- Kopja e librit të mjeteve fikse të subjektit tregtar - kërkuarit (llogaria 012 – impiante dhe pajisje) me gjendjen nga data e shpalljes së Thirrjes publike (me nënshkrim dhe vulë nga personi i autorizuar i subjektit tregtar – kërkuarit dhe kontabilistit të autorizuar);
- Kopje e lejes së menaxhimit të mbetjeve të lëshuar nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor (dokumenti nevojitet vetëm për kërkuarit që parashtrojnë dokumentacionin për aktivitet 1.4 nga pjesa I – Lëndë e Thirrjes publike);

Thirrja publike dhe të gjitha dokumentet shoqëruese edhe atë formularët (Formulari nr. 1, 2, 3, 4 dhe 5), rregulloret (Shtojca nr. 1 dhe 2) dhe udhëzues (Shtojca nr. 3, 4, 5 dhe 6), janë të arritshme në formë elektronike në faqen e internetit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës www.economy.gov.mk, dhe në formë letre mund të merren nga Sekretaria e arkivit të Ministrisë së Ekonomisë në rr. „Jurij Gagarin“ nr. 15, 1000 Shkup

Dokumentet e nevojshme për paraqitje në Thirrjen publike duhet të dorëzohen të kompletuara, përkatësisht kërkesa përkatëse me të gjitha dokumentet shoqëruese. Kërkesa dhe Raporti për projektin e realizuar duhet të nënshkruhen nga personi përgjegjës i subjektit afarist - kërkuarit dhe të vërtetohen me vulë .

¹¹ Përshkrim i shkurtër i projektit zhvillimor dhe aktiviteteve të realizuara në lidhje me të.

Dokumentacioni i plotë dorëzohet në origjinal ose kopje. Nëse dokumentacioni dorëzohet në kopje, besueshmërinë e secilës faqe e vërteton personi përgjegjës i subjektit afarist me nënshkrim dhe e vërteton me vulë. Dokumentacioni në gjuhë të huaj dorëzohet në kopje dhe përkthim të vërtetuar nga përkthyes i autorizuar gjyqësor.

V

Mënyra dhe afati për parashtrimin e kërkesave

Kërkesa e plotësuar së bashku me dokumentacionin shoqërues duhet të parashtrihen në zarf të mbyllur personalisht në Sekretarinë e arkivit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës, në rr. „Jurij Gagarin“ nr. 15, 1000 Shkup, çdo ditë pune nga ora 9:30 deri në orën 15:00 ose dërgohet me postë të rekomanduar.

Në zarfin e mbyllur:

- në pjesën e përparme të zarfit duhet të qëndrojë:

Drejtuar: Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës

Për THIRRJEN PUBLIKE për kompensimin e një pjese të kostove të subjekteve afariste për vendosjen e konceptit të ekonomisë cirkualre, me shenjën “MOS e HAP”.

- në pjesën e pasme të zarfit duhet të qëndrojë:

Emërtimi dhe selia e subjektit afarist.

Nëse kërkesa dorëzohet përmes postës, data e parashtrimit të së njëjtës do të jetë data kur kërkesa ka mbërritur dhe regjistruar në Sekretarinë e arkivit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës.

Një kërkues mund të parashtrojë vetëm për një nga aktivitetet e definuara në Pjesën I – Lëndëe e Thirrjes publike dhe vetëm një herë sipas Thirrjes publike.

Afati përfundimtar për dorëzimin e kërkesave është 11 nëntor të vitit 2024 dhe kërkesat që do të mbërrijnë pas përfundimit të afatit për dorëzimin e dokumenteve nuk do të merren në konsideratë.

Për shqyrtimin e kërkesave, Ministria e Ekonomisë dhe Punës do të formojë Komision. Nëse gjatë shqyrtimit Komisioni përcakton se dokumentet nuk janë të kompletuara, njofton me e-mail subjektin afarist nga i cili do të kërkojë që dokumentet të rregullohen dhe dorëzohen në afat prej tre ditëve. Dokumentet e korrigjuara dorëzohen nëpërmjet Sekretarisë së arkivit si datë e parashtrimit të dokumenteve konsiderohet data e parashtrimit të fundit.

VI

Mënyra e njoftimit dhe qasja në informacione shtesë

Lista e subjekteve afariste - kërkuesve që realizojnë të drejtën e kompensimit do të publikohet në faqen e internetit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Punës.

Çdo pyetje shtesë në lidhje me Thirrjen publike mund të bëhet në emailin e mëposhtëm: jpipoo@economy.gov.mk.

Ministria e Ekonomisë dhe Punës rezervon të drejtën, gjatë përcaktimit të përmbushjes së kushteve sipas Thirrjes publike, të bëjë inspektim dhe/ose të kërkojë dokumentacion shtesë nga subjekti afarist - kërkuesi, me qëllim që të indet nëse kostot janë bërë me të vërtetë dhe janë në përputhje me dëshmitë e dorëzuara.